



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 171 Prot.

Gjirokastrë, më 07/02/2019

V E N D I M

Nr. 02 datë 07.02.2019

Në mbështetje të ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 " Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38/1 si dhe statutit të universitetit "Eqrem Çabej" neni 14, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë në mbledhjen e tij të datës 07.02.2019.

V E N D O S I:

1. Të anullojë pikën 1 të vendimit të Senatit Akademik nr. 25 datë 26.09.2017, "niveli B1 i njohjes së gjuhës angleze", për pranimin në programet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Arsim Fillor kl. I-VI, për studentët që kanë përfunduar studimet e tyre në vitin akademike 2017-2018 dhe për ata student që do të përfundojnë studimet në vitin akademik 2018-2019, sepse bazuar në nenin 83 pika b e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 " Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë " ky program studimi do të trajtohet si program i ciklit të dytë "Master Profesional".

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 911 prot.

Gjirokastër, më 06.07.2018

VENDIM

Nr. 15, datë 06.07.2018


Në zbatim të ligjit Nr. 80/15 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nen 76 pika 4; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 30 pika 2.1; Nr. 52, datë 3.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë (Ndryshuar me udhëzimin nr.11, datë 30.6.2016); vendimit të Senatit Akademik Nr. 26, datë 20.10.2017, si dhe në propozimin e Rektoratit, datë 05.07.2018, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 05.07.2018 mori në shqyrtim çështjen e provimit të gjuhës së huaj për studentët që vazhdojnë programet "Master i Shkencave". Pasi u diskutua propozimi i rektoratit Senati Akademik me votat unanime të senatorëve të pranishëm

VENDOSI

1. Studentët e programeve "Master i Shkencave" të depozitojnë pranë sekretarive përkatse mësimore dëshminë e gjuhës së huaj në nivelin B₁.
2. Mos sjellja e dëshmisë sipas nivelit të përmendur në pikën 1 penalizon studentin për të tërhequr dokumentin e diplomës.
3. Deri në momentin e sjelljes së dëshmisë nuk do të lëshohet asnjë lloj dokumenti që vërteton diplomimin e studentit

Prof.dr. Baktash Mema

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Tel. 00355 84 63408
e-mail: rektori@uogj.edu.al
[http www.uogj.edu.al](http://www.uogj.edu.al)

Gjirokastrë, më 26 /09/2017

VENDIM

Nr. 25 datë 26 . 09. 2017

Në mbështetje të *nenit 38/1 pika h*, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe statutit të UGJ-së *neni 14 pika 14*, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë në mbledhjen e tij të datës 26 .09.2017,

Vendos i:

1. Të miratohet niveli B1 i njohjes gjuhës angleze si kriter hyrës për pranimin në programet e Ciklit të dytë "Master i Shkencave".
2. Të miratohet niveli C1 i njohjes gjuhës angleze si kriter hyrës për pranimin në programet e Ciklit të tretë .

Prof.dr.Bekdash MEMA
KRYETARI I SENATIT

